



## REZULTATET E RIVLERËSIMIT

Në përfundim të procesit Komisioni mund të vendosë për gjyqtarin/prokuratorin:

### 1 KONFIRMIM NË DETYRË

Kur është arritur nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### 2 PEZULLIM NGA DETYRA

Si dhe detyrim për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë 1 vjeçare pranë Shkollës së Magjistraturës.

### 3 SHKARKIM NGA DETYRA

Kur subjekti ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka rezultuar me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës dhe është cilësuar "i papërshtatshëm" gjatë vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike.

Qendra Europiane dhe Qendra ALTRI prezantojnë me kënaqësi punën e tyre në kuadër të projektit "Për një gjyqësor të pavarur dhe profesional: bashkëpunohet tani!", të zbatuar si pjesë e planit të veprimit të Koalicionit "Drejtësi për të gjithë".

## JU MIRËPRESIM NË FORUMET DHE DISKUTIMET TONA



QENDRA EUROPIANE  
QENDRA ALTRI  
KOALICIONI "DREJTËSI  
PËR TË GJITHË"

#bashkepunoedheti

[www.euro-centre.eu](http://www.euro-centre.eu)  
[info@euro-centre.eu](mailto:info@euro-centre.eu)

[www.altri.al](http://www.altri.al)  
[qendra.altri@gmail.com](mailto:qendra.altri@gmail.com)



# PROCESI I VETINGUT



# ÇFARË ËSHTË VETINGU?

Vetingu është rivlerësimi kalimtar i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të vendit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.



Tre janë rezultatet e këtij vlerësimi:

## a I AFTË

Gjyqtari/prokurori ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e subjekteve të përfshira në proceset gjyqësore, është efektiv dhe eficient në punë.

## b ME MANGËSI

Gjyqtari/prokurori ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar të drejtat e palëve dhe nuk është efektiv. Rekomandohet ndjekja e një programi trajnimi deri në 1 vit pranë Shkollës së Magjistraturës.

## c I PAPËRSHTATSHËM

Gjyqtari/prokurori ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar të drejtat e palëve dhe nuk është efektiv. Ndjekja e një programi trajnimi deri në 1 vit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund të përmirësojë situatën.

## PROCESI I RIVLERËSIMIT

Institucionet e rivlerësimit janë:

- » KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT;
- » KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT;
- » KOMISIONERËT PUBLIKË.

Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tre kritereve:

### VLERËSIMI I PASURISË

Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët kanë detyrim të dorëzojnë **deklaratën e pasurisë dhe të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë**, pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Kontrolli i pasurisë kryhet edhe mbi bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si edhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit.

ILDKPI-ja ka detyrim të kontrollojë këto deklarime.

### KONTROLLI I FIGURËS

Të gjithë subjektet e rivlerësimit duhet të plotësojnë deklaratën e kontrollit të figurës.

Institucionet e vetingut dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kanë detyrim të verifikojnë nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

### VLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

Ky kriter ka të bëjë me vlerësimin e aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit për 3 vitet e fundit.